

MT30

# MOVETIME

Family Watch

Udhëzuesi i shpejtë



**TCL**

# Njohja me orën

Altoparlanti



Porta e karikimit



## Tasti i ndezjes


- Shtype gjatë për 3 s për ta ndezur/fikur.
- Shtype gjatë për 10 s për të detyruar rindezjen.
- Shtype shkurt për t'u kthyer direkt tek ekrani Kryesor. Shtype sërish për të fikur ekranin.

## Tasti SOS

- Shtype gjatë për 5 s për të bërë një telefonatë SOS.
- Shtype shkurt për t'u kthyer direkt tek ekrani i mëparshëm.

## Shënim:


- Shtyp çdo tast për të zgjuar pajisjen.
- Rrëshqite djathtas për t'u kthyer tek ekrani i mëparshëm.
- Mos i hiq vidat. Ndryshe, mund të dëmtohet pajisja.



# Konfigurimi i orës

## Vendosja e një karte SIM



Nevojitet një nano-SIM (nuk përfshihet) për të konfiguruar dhe përdorur orën tënde. Kontakto me operatorin e rrjetit për të kërkuar një nano-SIM me plan tarifor për telefonata dhe të dhëna.



## Futja e kartës SIM


Referoju hapave të mëposhtëm kur fut kartën SIM.<sup>(1)</sup>

1. Hiq rripin.




<sup>0</sup> Mos lejo që fëmijët të instalojnë/heqin rripin e orës ose kartën SIM pa mbikëqyrje.


2. Hiq kapakun e kartës SIM dhe fut kartën SIM.




3. Shtyje kartën SIM lehtë duke përdorur piskatore dhe vendos kapakun.



4. Vendos rripin në vend.




1



2


# Karikimi i orës

1. Sigurohu që kunjat në stacionin e karikimit të jenë të bashkërenditura me kunjat në pjesën e pasme të orës.





2. Duke përdorur një kabllo USB, lidh stacionin e karikimit me një kompjuter ose përshtatës rryme USB për të filluar karikimin.



## Ndezja/fikja e orës

Shtyp gjatë **Tastin Ndezje** për 3 sekonda për të ndezur/fikur orën.

## Gjuha

Do të të kërkohet të zgjedhësh një gjuhë sistemi kur ndez orën për herë të parë. Për të ndryshuar gjuhën e sistemit kur ora është e paçiftuar, rrëshqit djathtas 2 herë nga ekrani kryesor dhe zgjidh një gjuhë.



# Shkarkimi dhe instalimi i aplikacionit në smartfon


Për të shkarkuar aplikacionin:

- Kërko për "TCLMOVE" në Google Play Store (Android 4.3 e lart) ose App Store (iOS 8.0 e lart).
- Skano kodin e mëposhtëm QR.



## Krijimi dhe identifikimi në llogari

Prek **Regjistrohu** për të krijuar llogarinë e TCLMOVE dhe fut adresën e emailit dhe fjalëkalimin për t'u identifikuar.



## Çiftimi

Sigurohu që karta SIM të jetë futur saktë dhe të jesh i lidhur me internetin përpara se të çiftosh orën me telefonin. Në pjesën e sipërme majtas të orës do të shfaqet **G**, **E** ose **3G** pasi të lidhet me internetin.



## 1. Çiftimi i orës me telefonin

Ekzistojnë 2 mënyra për të çiftuar orën me telefonin.

- Skano kodin QR për të çiftuar orën

Rrëshqit majtas nga ekrani kryesor i orës për të marrë kodin QR kur çiftosh orën për herë të parë.



- Fut numrin IMEI për të çiftuar orën

Numri IMEI është i printuar në një etiketë në paketimin e pajisjes. Gjithashtu mund të rrëshqasësh majtas nga ekrani kryesor i orës për të marrë numrin IMEI kur çifton orën për herë të parë. Fut numrin IMEI të MOVETIME Family Watch dhe prek **Konfirmo** për të çiftuar orën me telefonin.



Një kod verifikimi do të dërgohet tek ora dhe do të shfaqet në ekran. Fut kodin e verifikimit dhe prek **Konfirmo**.

2. Fut numrin e telefonit.
3. Fut marrëdhënien.

4. Fut emrin dhe numrin e telefonit të fëmijës (numri i telefonit i kartës SIM të futur në orë). Plotëso informacionin personal të fëmijës (fotografinë e profilit, ditëlindjen, gjatësinë etj.) dhe prek **U krye**.

Informacioni personal i fëmijës tënd do të shfaqet si më poshtë:



Pasi të jetë çiftuar me sukses MOVETIME Family Watch me telefonin tënd, do të kalosh tek ekrani kryesor i aplikacionit. Vëndndodhja e orës do të shfaqet këtu në hartë.




## Shtimi i një anëtarit familjeje

Anëtarët e familjes mund të shtohen duke përdorur aplikacionin e administratorit qoftë manualisht ose duke skanuar një kod QR.


### Shtimi i një anëtarit familjeje manualisht

1. Prek **Unë** në ekranin kryesor të aplikacionit.
2. Zgjidh një Family Watch.
3. Prek **Kontaktet e Family Watch**.
4. Prek **Anëtarët e familjes**.
5. Prek **+** dhe më pas zgjidh **Shto manualisht**.
6. Fut një emër/marrëdhënie dhe një numër. Mund të ngarkosh gjithashtu edhe një fotografi (opsionale).
7. Prek **Ruaj**.



## Shtimi i një anëtarri familjeje me kod QR

1. Prek **Unë** në ekranin kryesor të aplikacionit.
2. Zgjidh një MOVETIME Family Watch.
3. Prek **Kontaktet e Family Watch**.
4. Prek **Anëtarët e familjes**.
5. Prek **+** dhe më pas zgjidh **Skano kodin QR**.
6. Në ekran do të shfaqet një kod QR. Nëse anëtarri i ftuar i familjes është pranë teje, ai mund ta skanojë atë direkt duke përdorur aplikacionin e vet **TCLMOVE**. Nëse anëtarri i ftuar i familjes nuk është pranë, prek **+** për t'i dërguar kodin QR.



# Përdorimi i orës

## Ekrani

Prek **Tastin Ndezje** për të zgjuar ekranin Kryesor.



## Përdorimi i ekranit me prekje



### Prek

Për të zgjedhur një aplikacion ose për të konfirmuar një veprim, përdor gjithin për ta prekur.



### Rrëshqit majtas/djathtas

Rrëshqit majtas/djathtas për të parë aplikacionet, cilësimet dhe funksionet.



## Rrëshqit lart/poshtë

Rrëshqit lart nga ekrani Kryesor për të parë njoftimet. Rrëshqit poshtë nga ekrani Kryesor për kontrollet e volumit dhe ndriçimit.



## Ndryshimi i fushës së orës

Shtyp gjatë ekranin Kryesor, rrëshqit majtas për të parë opsionet e ndryshme dhe prek një fushë ore për ta zgjedhur.

## Telefonimi


### Telefonimi një anëtar të familjes ose një shoku


Për të parë kontaktet e familjes, rrëshqit majtas nga ekrani Kryesor dhe prek **Familja** ose **Shokët**. Prek kontaktin për të kryer një telefonatë.




## Mesazhi zanor

### Dërgimi i një mesazhi zanor

Prek **Familja, Shokët** ose **Bisedë në grup** për të zgjedhur një kontakt ose grup. Mbaj shtypur  për ta regjistruar dhe lëshoje për ta dërguar.

Prek  për të zgjedhur dhe dërguar një emoji.




**Shënim:** Nëse dështon dërgimi i mesazhit zanor ose i emoji, do të shfaqet  pranë imazhit. Prek ikonën për ta ridërguar mesazhin.

## Shokët


### Shtimi i shokëve të rinj



Rrëshqit majtas nga ekrani Kryesor dhe prek **Shokët**. Mbaj të dy orët pranë, tundi dhe prek **OK**.



**Shënim:** Mund të shtohen deri në 15 shokë.

### Fshirja e një shoku


Shtyp gjatë një shok në listën e kontakteve. Prek ikonën Fshi që më pas shfaqet në ekran. Prek  për ta konfirmuar ose prek  për ta anuluar.



## Bisedë në grup


### Krijimi i një grupi

Shto shokë në fillim përpara se të krijosh një grup. Rrëshqit majtas nga ekrani Kryesor dhe prek **Bisedë në grup**. Prek **Krijo një grup**. Zgjidh një fotografi për grupin dhe fto shokët. Prek  për të krijuar një grup ose prek  për ta anuluar.




# Heqja e kartës SIM

1. Hap kapakun e kartës SIM, shtyje kartën SIM me lehtësi duke përdorur piskatore.



2. Hiqe kartën SIM me kujdes.





## Njoftim për papërshkueshmërinë nga uji

Ky produkt ka një vlerësim IP67 dhe është i përshtatshëm për përdorim të përditshëm. MOS e përdor kur noton, zhytesh dhe kur bën dush.



## Më shumë informacion

Për më shumë informacion, referoju seksionit të ndihmës në aplikacionin TCLMOVE ose vizito [www.tcl.com.com/wearables/familywatch](http://www.tcl.com.com/wearables/familywatch).



CJB1JM0LCAAC